



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 447/1 prot.

Tiranë, më 10/03/2021

V E N D I M

Nr. 42, datë 10/03/2021

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 141, datë 26.11.2020, e shtetases V.K, në cilësinë e përfaqësueses së vajzës së saj shtetases E.T kundër Zyrës së Shoqërisë Aleat sh.p.k. Elbasan dhe Zyrës së Gjendjes Civile Elbasan, në të cilën pretendohet diskriminim *për shkak të gjendjes shëndetësore¹ dhe aftësisë së kufizuar².*

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesja sqaron se, vajza e saj është e diagnostikuar me skizofreni reflektore me defiqite, arsye për të cilën ajo trajtohet me ndihmë paaftësie. Subjekti ankues pretendon se, gjendja shëndetësore dhe jetesa e mbyllur në shtëpi, i kanë shkaktuar vajzës së saj mbipeshë të konsiderueshme dhe vështirësi serioze në lëvizje. Në muajin Gusht 2020, E.T është prekur nga Covid-19 dhe si rezultat ka pësuar infarkt parietal posterior dhe trombozë, çka i ka shkaktuar paralizë të pjesshme dhe ka bërë të pamundur lëvizjen edhe për nevojat më elementare.

Sipas subjektit ankues, referuar gjendjes së saj shëndetësore, E.T përfiton pagesë për aftësinë e kufizuar. Për rinovimin e dokumentacionit për vazhdimin e trajtimit me pagesën e aftësisë së kufizuar, një ndër dokumentat e kërkuar është dhe Karta e Identitetit.

Në kushtet që më datë 01.12.2020, këtij dokumenti i përfundon vlefshmëria, ankueses i duhet të bëjë rinovimin e tij. Në këtë kuptim, më datë 11.11.2020, subjekti ankues është drejtuar pranë

¹ Për shkak se e bija e ankueses është paralizuar pjesërisht.

² Për shkak se e bija e ankueses është me aftësi të kufizuar.

Zyrës së Gjendjes Civile Elbasan dhe Zyrës së Shoqërisë Aleat sh.p.k., Elbasan dhe ka kërkuar informacion lidhur me hapat që duhet të ndjekë për të bërë rinovimin e kartës së identitetit të vajzës së saj, duke qënë se ajo e ka të pamundur të paraqitet fizikisht në këto institucione. Në rrugë verbale, ankuesja pretendon se është informuar nga ana e përfaqësuesve të dy institucioneve të sipërcituara, se shërbimi i kërkuar në kushte banese, mund të ofrohet vetëm me kushtin që të aplikohet për një pasaportë, me një tarifë shërbimi prej 18.000 lekë. Gjithashtu, në momentin e aplikimit të pasaportës bëhet edhe ai i kartës së identitetit me një tarifë prej 1500 lekë.

Pra, përsa më sipër, subjekti ankues pretendon se detyrimi për të paguar një tarifë shërbimi të panevojshme për marrjen e pasaportës, e ka vendosur vajzën e saj përpara një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, për shkak të gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ankuesja ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të vajzës së saj nga ana e subjekteve ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, si dhe ofrimin e shërbimit për rinovimin e kartës së identitetit dhe pasaportës në banesë me një tarifë standarde ose falas, për të dhe personat që ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “c”, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”³, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të hetuar dhe shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Bazuar në nenin 33, pika 3, të LMD-së, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. *Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj*”.

Referuar nenit 33, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “1. *Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative; b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative.* 2. *Në procedurën administrative janë gjithashtu palë edhe mbajtësit e interesave publikë të autorizuar me ligj, si dhe mbajtësit e interesave kolektivë apo interesave të gjerë të publikut, nëse këta interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative.*”

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar.

Neni 3, i Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. Ndërsa në Kreun III, të ligjit parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20/1 të tij parashikon se: “1. *Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenti 7 të LMD-së, të ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Pas analizimit paraprak të ankesës sipërcituar, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonin kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1651/1 prot., datë 02.12.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga Shoqëria Aleat sh.p.k., Ministria e Brendshme, Zyra e Gjendjes Civile Elbasan dhe Zyra e Shoqërisë Aleat sh.p.k. në Elbasan, për ankesën e bërë nga V.K. Në mënyrë të specifikuar është kërkuar:
 - Informacion lidhur me procedurën që ndiqet nga ana e Shoqërisë Aleat sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të pajisjes me pasaportë apo kartë identiteti, për qytetarët të cilët e kanë të pamundur të aplikojnë pranë zyrave të shoqërisë. Kopje të dokumentit ku është parashikuar kjo procedurë.
 - Informacion nëse personave me aftësi të kufizuara apo të gjithë personave të tjerë të cilët e kanë të pamundur të paraqiten pranë zyrave të Shoqërisë Aleat sh.p.k., i ofrohet shërbimi në banesë/vendqëndrim, për pajisjen vetëm me kartë identiteti apo me pasaportë.

- Informacion nga ana e Ministrisë së Brendshme dhe Shoqërisë Aleat sh.p.k., nëse janë parashikuar lehtësira (në çmim apo procedura) për personat me aftësi të kufizuara apo për kategori të tjera, në kontratën koncesionare për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Ministria e Brendshme me anë të shkresës⁴ nr. 8670/1 prot., datë 11.12.2020, ndër të tjera sqaroi se: *“...Nga informacionet e marra nga Zyra e Gjendjes Civile Bashkia Elbasan, shtetësja V.K ka kërkuar që vajza e saj e cila është me probleme shëndetësore të marrë shërbim në banesë për pajisjen me dokumenta biometrik. Zyra e gjendjes civile ka sqaruar V.K, se ky shërbim ofrohet kundrejtë pagesës për letërnjoftimin 1500 (njëmijë e pesqind) lekë dhe pasaportë biometrike 18.000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë (në total 19.500 lekë).*

Në kontratën koncesionare ‘Për prodhimin dhe shpërndarjen e letërnjoftimeve elektronike dhe pasaportave biometrike’, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë grupimit SAGEM Securite (aktualisht me emrin Safran Identity and Security) dhe Fondin Shqiptaro-Amerikan të ndërmarrjeve, ratifikuar me ligjin nr. 9972, datë 28.07.2008, i ndyshuar, zgjatur, përmirësuar dhe miratuar me ligjin nr. 10322, datë 23.09.2010 dhe ligjin nr. 129/2013, datë 25.04.2013, nuk parashikohet lehtësira (në çmim apo procedura) për pajisjen me letërnjoftim elektronik dhe pasaportë biometrike, për personat me aftësi të kufizuara apo kategori të tjera.

Përsa më sipër ky është një shqetësim i adresuar nga Ministria e Brendshme në disa takime dhe negociata me Koncesionarin dhe nuk ka gjetur mbështetjen e tyre për amendim të kontratës koncesionare dhe ofrim të lehtësirave në pagesa për këto kategori, amendim i cili duhet të ketë një dispozitë të veçantë ligjore...”

Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Elbasan, në përgjigje të shkresës së sipërcituar, me anë të shkresës⁵ nr. 85 prot., datë 10.12.2020, ndër të tjera sqaroi se: *“...Zyra e gjendjes civile në punën e saj zbaton me përpikmëri Ligjin 10129, datë 11.05.2009 ‘Për gjendjen civile’, si dhe të gjitha aktet nënligjore në zbatim të tij. Ministria e Brendshme, pjesë e së cilës është edhe shërbimi i gjendjes civile ka lidhur me Kompaninë Aleat sh.p.k., kontratën koncesionare ‘Për prodhimin dhe shpërndarjen e letërnjoftimeve elektronike dhe pasaportave biometrike, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë grupimit SAGEM Securite dhe Fondin Shqiptaro-Amerikan të ndërmarrjeve, ratifikuar me ligjin nr. 9972, datë 28.07.2008, i ndyshuar, zgjatur, përmirësuar dhe miratuar me ligjin nr. 10322, datë 23.09.2010 dhe ligjin nr. 129/2013, datë 25.04.2013’. Procedurat e aplikimit dhe pajisjes së shtetasve me dokumente biometrike, janë pjesë e zbatimit të kësaj kontrate.”*

Në përfundim, Kompania Aleat sh.p.k., me shkresën⁶ nr. JAJ/20-1172, sqaroi ndër të tjera se: *“...në asnjë rrethanë ALEAT nuk ka diskriminuar ankuesen as ka ushtruar trajtim të padrejtë*

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1834 prot., datë 28.12.2020

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1651/2 prot., datë 15.12.2020.

⁶ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1651/3 prot., datë 16.12.2020.

ndaj kësaj shtetase, në kuptim të neneve 3/1 dhe 7/1 të LMD-së, të ndryshuar...ALEAT dëshiron të theksojë se sipas Kontratës së Koncesionit, shërbimet e rregjistrimit ofrohen vetën në zyrat e Njësive Vendore Administrative (NJVA), duke kërkuar praninë fizike të qytetarit dhe të nëpunësit të Zyrës së Gjendjes Civile. Në fakt, ofrimi i shërbimeve të aplikimit jashtë Zyrës së Aplikimit nuk është një detyrim kontraktor apo pjesë e shërbimeve të kontratës së koncesionit për prodhimin e kartave të identitetit dhe të pasaportave biometrike, të nënshkruar nga ALEAT me Ministrinë e Brendshme në vitin 2008 ('AUTORITETI').

Sidoqoftë, në raste të jashtëzakonshme, vetëm me kërkesën e shprehur nga AUTORITETI, ALEAT ofron shërbimin e kryerjes së aplikimit jashtë Zyrës së Aplikimit, veçanërisht për ata aplikantë që janë në gjendje kritike shëndetësore dhe të cilët kanë nevojë për tu pajisur me pasaportë për të udhëtuar jashtë vendit për arsye mjekësore. Në kuadër të kontratës së koncesionit, deri më tani, për të kryer këtë shërbim shtesë si dhe për të mbuluar nevojat e tij, kjo kryhet nëpërmjet vënies në dispozicion të shërbimit tonë Express për prodhimin e Dokumentave Biometrike të Identitetit (fast-track).

Në këtë drejtim, ne do të dëshironim të theksojmë se edhe shërbimi Express i rënë dakord në kontratë kërkon praninë fizike të qytetarit në zonat tona. Sidoqoftë, me konfirmimin e AUTORITETIT, për të ndihmuar shtetasit shqiptarë të shtruar në spital, me aftësi të kufizuara, si dhe shtetasit të cilët nuk janë në gjendje të jenë të pranishëm fizikisht pranë zyrave të aplikimit, kryesisht për tu pajisur me pasaportë, e ndonjëherë edhe për tu pajisur me kartë identiteti, ky shërbim ofrohet në vendbanimin e qytetarit, (ose në spital), me tarifën e shërbimit tonë Express, pa kosto të tjera shtesë për qytetarin.

Pavarësisht nga sa më sipër, ALEAT vazhdimisht ka demonstruar disponueshmërinë për të mbështetur më tej qytetarët që kanë nevojë për shërbime të tilla. Në këtë drejtim, në frymën e përmirësimit të vazhdueshëm, ALEAT i ka sugjeruar AUTORITETIT që të krijojë disa zyra të posaçme aplikimi të dedikuara e të mirëpajisura për nevojat e aplikantëve me aftësi të kufizuara, duke sugjeruar nëse është e nevojshme, transportin e tyre mjekësor përmes ambulancës apo mjeteve të tjera.

ALEAT shpreh angazhimin e saj për të vazhduar punën drejt ofrimit të shërbimeve cilësore për të gjithë aplikantët, veçanërisht për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, dhe mbetet e hapur për të bashkëpunuar me Komisionerin dhe AUTORITETIN për çdo informacion të mëtejshëm të nevojshëm për shërbimet e koncesionit. Për këtë rast të veçantë, në frymën e mirë të bashkëpunimit dhe ndihmës, nëse kërkohet nga AUTORITETI, ALEAT mund të sigurojë shërbimin e dedikuar të aplikimit jashtë Zyrës së Aplikimit pa asnjë kosto shtesë për aplikanten për pjesën e tij të përshpejtuar e të dedikuar.”

III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës Nr. 141, datë 26.11.2020, Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe jo të barabartë.

Komisioneri ka shqyrtuar çështjen bazuar në situatën e konstatuar, provat dhe informacionin e administruar gjatë procedurës administrative të zhvilluar.

Ankuesja ka paraqitur fillimisht ankesë kundër Zyrës së Shoqërisë ALEAT sh.p.k. Elbasan dhe Zyrës së Gjendjes Civile Elbasan. Komisioneri konstaton se Zyra e Shoqërisë ALEAT sh.p.k. Elbasan, është pjesë e Shoqërisë ALEAT sh.p.k. dhe ushtron aktivitetin e saj në qytetin e Elbasanit. Referuar shkresës nr. 85 prot., datë 10.12.2020, të Zyrës së Gjendjes Civile Elbasan, shërbimi i gjendjes civile ofrohet nga Ministria e Brendshme. Në këtë kuptim, Komisioneri vlerësoi se subjektet ndaj të cilëve duhet të zhvillohet procedura e shqyrtimit të ankesës janë Shoqëria ALEAT sh.p.k. dhe Ministria e Brendshme.

Pretendimi për diskriminim i ankuses V.K mbështetet në faktin që aftësia e kufizuar dhe gjendja shëndetësore e vajzës së saj, nuk i lejon që ajo të mund të aplikojë për tu pajisur me kartë identiteti, si të gjithë qytetarët e tjerë, për shkak se ajo e ka të pamundur të aksesojë Zyrat e Kompanisë ALEAT sh.p.k. Gjithashtu, ajo ndodhet përpara faktit që kartës së identitetit të vajzës së saj i ka përfunduar vlefshmëria dhe në këtë situatë ajo e ka të pamundur të përfitojë nga shërbimet shëndetësore të nevojshme. Referuar gjendjes së saj shëndetësore, E.T⁷ përfiton pagesë për aftësinë e kufizuar. Për rinovimin e dokumentacionit për vazhdimin e trajtimit me pagesën e aftësisë së kufizuar, një ndër dokumentat e kërkuar është dhe karta e identitetit.

Duke qënë se sipas informacionit që ajo ka marrë, ALEAT sh.p.k., nuk ofron këtë shërbim në banesë, ankuesja ndodhet përpara një situatë në të cilën nuk gjen zgjidhje dhe rrezikon të mbetet pa marrë shërbimet mjekësore të nevojshme dhe pa përfituar pagesën e aftësisë së kufizuar.

Sipas informacionit të administruar, shërbimi i kërkuar në kushte banese, mund të ofrohet vetëm me kushtin që të aplikohet për një pasaportë, me një tarifë shërbimi prej 18.000 lekë dhe në momentin e aplikimit bëhet edhe ai i kartës së identitetit me një tarifë prej 1500 lekë. Pra, në këto kushte ankuesja është e detyruar për të paguar një tarifë shërbimi të panevojshme për marrjen e pasaportës, kur asaj nuk i shërben dhe nuk mund ta përdorë.

Për sa më sipër, referuar Kontratës Konçesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e letërnjoftimeve elektronike dhe pasaportave biometrike”, lidhur ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë grupimit SAGEM Securite (aktualisht me emrin Safran Identity and Security) dhe Fondin Shqiptaro-Amerikan të ndërmarrjeve, ratifikuar me ligjin nr. 9972, datë 28.07.2008, i ndryshuar, zgjatur, përmirësuar dhe miratuar me ligjin nr. 10322, datë 23.09.2010 dhe ligjin nr. 129/2013, datë 25.04.2013, si dhe informacionit të përcjellë nga ana e ALEAT sh.p.k., nuk parashikohen lehtësira (në çmim apo procedura) për pajisjen me

⁷ Vajza e subjektit ankues

letërnjoftim elektronik dhe pasaportë biometrike, për personat me aftësi të kufizuara apo kategori të tjera të pamundura.

Gjatë procedurës së hetimit administrativ ka rezultuar se E.T, ndodhet përpara situatës në të cilën, e ka të domosdoshme të bëj rinovimin e dokumentacionit sa i përket vijimit të trajtimit me pagesë të aftësisë së kufizuar. Fakti që ajo ka kartën e identitetit jashtë afateve të vlefshmërisë, bën të pamundur kryerjen e veprimeve të sipërcituara dhe ndërprerjen e pagesës së aftësisë së kufizuar. Kjo situatë mund të sjellë si pasojë pamundësinë për të siguruar barnat apo kushtet mjekësore për trajtimin shëndetësor të saj.

Mbështetur në informacionin e përcjellë nga palët, Ministria e Brendshme, ka informuar se Zyra e Gjendjes Civile ka sqaruar ankuesen, se shërbimi i kërkuar prej saj mund t'i ofrohet kundrejtë pagesës për letërnjoftimin⁸ 1500 (njëmijë e pesqind) lekë dhe pasaportë biometrike⁹ 18.000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë (në total 19.500 lekë). Sipas ankueses, vajza e saj e ka të pamundur të aplikojë pranë zyrave të ALEAT sh.p.k., si dhe në gjendjen shëndetësore në të cilën gjendet nuk i nevojitet pajisja me pasaportë biometrike.

Nga informacioni i marrë nga ana e Shoqërisë ALEAT, sqarohet se ky është një shërbim që ofrohet në raste të jashtëzakonshme, vetëm me kërkesën e shprehur nga AUTORITETI (Ministria e Brendshme), veçanërisht për ata aplikantë që janë në gjendje kritike shëndetësore dhe të cilët kanë nevojë për tu pajisur me pasaportë për të udhëtuar jashtë vendit për arsye mjekësore. Në kuadër të Kontratës së Koncesionit, deri më tani, për të kryer këtë shërbim shtesë si dhe për të mbuluar nevojat e tij, kjo kryhet nëpërmjet vënies në dispozicion të shërbimit tonë expres për prodhimin e Dokumentave Biometrike të Identitetit (fast-track).

Sipas ALEAT sh.p.k., ky shërbim është ofruar në vendbanimin e qytetarit, (ose në spital), me tarifën e Shërbimit Expres, pa kosto të tjera shtesë për qytetarin, me konfirmimin e AUTORITETIT, për të ndihmuar shtetasit shqiptarë të shtruar në spital, me aftësi të kufizuara, si dhe shtetasit të cilët nuk kanë qënë në gjendje të ishin të pranishëm fizikisht pranë Zyrave të Aplikimit, kryesisht për tu pajisur me pasaportë, e ndonjëherë edhe për tu pajisur me kartë identiteti.

Nga ana e Shoqërisë ALEAT sh.p.k. apo Ministrisë së Brendshme, nuk u vu në dispozicion të Komisionerit asnjë dokument apo marrëveshje, me anë të të cilës të evidentoheshin tarifat e përcaktuara për Shërbimin Expres apo se si është e parashikuar të veprohet në raste analoge me situatën në të cilën ndodhet ankuesja. Pavarësisht faktit që ky shërbim pretendohet të jetë kryer edhe me parë nga ana e Shoqërisë ALEAT sh.p.k., në ndihmë të shtetasve të pamundur fizikisht, nuk u vu në dispozicion asnjë marrëveshje për mënyrën e ofrimit të këtij shërbimi.

⁸ <https://www.aleat.al/al/leternjoftim-e-lektronik>

⁹ <https://www.aleat.al/al/pasaporte-biometrike>

Në rastin konkret, referuar certifikatës familjare¹⁰, ankuesja rezulton se është kryefamiljare dhe jeton e vetme me të bijën, e cila është me aftësi të kufizuara. Sipas, Vërtetimit Nr. 1547, datë 27.02.2018, E.T, ka nevojë për kujdes të vazhdueshëm të familjarit.

Në analizë të informacionit dhe legjislacionit të sipërcituar, ankuesja duke qënë se është e vetmja familjare që mund të kujdeset për të bijën, përfiton pagesë si ndihmëse personale e saj.

Në këto kushte, veç pamundësisë së të bijës për të aplikuar pranë zyrave të Shoqërisë ALEAT sh.p.k., ndodhet edhe në kushtet e pamundësisë ekonomike për të paguar shumën prej 19.500 lekë, për të marrë shërbimin expres për pajisjen me kartë identiteti dhe pasaportë biometrike.

Përsa më sipër, Komisioneri evidenton se Shoqëria ALEAT sh.p.k. dhe Ministria e Brendshme, pavarësisht se janë vënë në dijeni të situatave të tilla si në rastin e ankueses, nuk kanë ndërmarrë asnjë hap për të parashikuar, tarifa lehtësuese apo shërbim pa pagesë për persona me aftësi të kufizuara, në pamundësi ekonomike apo të pamundur fizikisht për shkak të gjendjes shëndetësore, për t'u paraqitur pranë zyrave të aplikimit. Në këtë kuptim, me anë të mosverpimeve të tyre, këta persona, të cilët pajisjen me kartë identiteti apo pasaportë biometrike dhe e kanë të domosdoshme dhe jetike, janë vendosur përpara një situatë të padrejtë dhe disfavorizuese.

Gjithashtu, fakti që Shoqëria ALEAT sh.p.k. dhe Ministria e Brendshme, vendos përpara detyrimit ankuesen dhe shtetasit të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të, në situatën që për të marrë kartë identiteti në vendbanimin e tyre, i duhet të aplikojnë njëkohësisht edhe për pasaportë biometrike, kur nuk i nevojitet, i vendos ata përpara një situatë të pafavorshme.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se në kuptim të nenit 7, pika 1, të LMD, të ndryshuar, Shoqëria ALEAT sh.p.k. dhe Ministria e Brendshme, kanë ekspozuar ankuesen dhe personat që ndodhen në të njëjtat kushte me të, me një qëndrim të padrejtë dhe disfavorizues, duke mos i siguruar mundësinë për pajisjen me kartë identiteti apo pasaportë biometrike në vendbanimin e tyre.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 1, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

¹⁰ Lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Elbasan, me Nr. 000942201, datë 21.11.2020

Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes shëndetësore, Komisioneri vlerëson se konsiderohen si shkaqe të mbrojtura, pasi parashikohen si të tillë në LMD dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se ajo i mbart këto shkaqe.

Referuar Vërtetimit Nr. 1547, datë 27.02.2018, E.T, e bija e ankueses, është person me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, mbështetur në Përmbledhjen e Daljes, së lëshuar nga Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë, E.T, rezulton të jetë prekur nga virusi Covid-19, i cili i ka shkaktuar Trompoz Cerebrale.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “aftësinë e kufizuar” dhe “gjendjen shëndetësore”.

Kuadri ligjor i zbatueshëm:

Me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”¹¹, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”¹². Bazuar në nenin 116, të Kushtetutës, ky akt ndërkombëtar i të drejtave të njeriut jo vetëm që bëhet pjesë e të drejtës së brendshme e detyrueshme për t’u zbatuar, por ka përparësi ndaj rendit tonë juridik.

KDPAK përfaqëson standartin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni 1). Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambjentit që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (Preambula e

¹¹ Në vijim dot’i referohemi me shkurtesën KDPAK.

¹²Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

KDPAK, gërma “e”). Rrjedhimisht në qendër të vëmendjes nuk duhet të jetë paaftësia/paafhtështë e mundshme, por kufijtë që ngre shoqëria duke penguar gëzimin e të drejtave. Nga ana tjetër KDPAK pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara.

Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet duhet të marrin masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në ambientet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruar për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për mundësimin, zbatohen ndër të tjera për: a) ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës; b) informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe shërbimet e emergjencës. (neni 9/1 KDPAK).

Aksesueshmëria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet, parashikohet nga Konventa si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Në pikën 2, të nenit 9, të KDPAK, parashikohet se: “2. Shtetet palë duhet gjithashtu të marrin masat e duhura: a) për të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar implementimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale për mundësimin e mjeteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruar për publikun; b) për të siguruar se subjektet private që ofrojnë mjete dhe shërbime, të cilat janë të hapura apo të siguruar për publikun, të marrin parasysh të gjitha aspektet e arritshmërisë dhe shfrytëzimit për personat me aftësi të kufizuara; c) për të siguruar trajnim për pjesëmarrësit në proces lidhur me çështjet e heqjes së barrierave që ndeshin personat me aftësi të kufizuara;...”

Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: “Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuara pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.”

Në kontekst të interpretimit të bërë nga ana e Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 6(2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, shtetet palë të kësaj konvente marrin përsipër detyrime të rëndësishme në lidhje me mosdiskriminimin dhe ruajtjen e barazisë së personave me aftësi të kufizuara. Në interpretim të neneve 5 dhe 25, të kësaj Konvente, shtetet

palë duhet të ndalojnë dhe parandalojnë refuzimin diskriminues të shërbimeve shëndetësore ndaj personave me aftësi të kufizuara, duke siguruar shërbime shëndetësore me ndjeshmëri gjinore, duke përfshirë të drejtat shëndetësore seksuale dhe të shëndetit riprodhues. Shtetet palë duhet të adresojnë format e diskriminimit, që shkelin të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, që pengojnë të drejtën për shëndet përmes shkeljes të së drejtës për të marrë shërbim shëndetësor, në bazë të një pëlqimi të lirë dhe të informuar, ose që i bëjnë të pamundur përfitimin e lehtësirave apo informacionit.

Gjithashtu referuar Komentit të Përgjithshëm Nr. 6(2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, në lidhje me përshtatjen e arsyeshme, ndër të tjera theksohet që:

“Përshtatja e arsyeshme” është një pjesë përbërëse e detyrimit për mos-diskriminim, detyrim ky i cili i nënshtrohet realizimit të menjëhershëm.

Detyrimet mbi përshtatjen e arsyeshme janë të ndryshme nga ato të aksesueshmërisë. Që të dy synojnë të garantojnë aksesin, por detyrimi për të siguruar aksesueshmërinë është një detyrim *ex ante*, ndërsa detyrimi për të siguruar përshtatje të arsyeshme është një detyrim *ex nunc*.

Detyrimi për të siguruar përshtatje të arsyeshme në përputhje me nenet 2 dhe 5 të Konventës mund të ndahet në dy pjesë përbërëse. Pjesa e parë imponon një detyrim ligjor pozitiv për të siguruar një përshtatje të arsyeshme, i cili është një modifikim ose rregullim që është i domosdoshëm dhe i përshtatshëm, kur kërkohet në një rast të veçantë, për të siguruar që një person me aftësi të kufizuara mund të gëzojë ose ushtrojë të drejtat e saj ose të tij. Pjesa e dytë e kësaj detyre siguron që ato përshtatje të kërkuara të mos imponojnë një barrë disproporcionale ose të panevojshme mbi subjektet e detyruara.

Detyrimi për të siguruar përshtatjen e arsyeshme, nuk duhet të ngarkojë personat me aftësi të kufizuara me shpenzimet e nevojshme për realizimin e përshtatjes. Gjithashtu, Komenti i Përgjithshëm nr. 6 (2018) vendos theksin tek fakti se barra e provës i takon subjektit që mbart detyrimin dhe që pretendon se barra e tij/saj do të ishte joproporcionale ose e padrejtë.

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*. Në nenin 3, pika 1, ky ligj përcakton se: *“Aksesueshmëri”* është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se: *“ 3. “Pengesat” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.”*

Në përputhje me qasjen e KDPAK edhe ky ligj sanksionon se aksesueshmëria është një nga parimet e këtij ligji (neni 3/ç) dhe se jetesa e pavarur e personave me aftësi të kufizuara mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë, ndër të tjera ofrimin e shërbimeve (neni 5/1).

Neni 3 pika 11 e këtij ligji parashikon: *“Përshtatje e arsyeshme” është modifikimi dhe rregullimet e nevojshme e të përshtatshme, atëherë kur është e nevojshme, pa vendosur barrë të tepruar, për t’u garantuar personave me aftësi të kufizuara gëzimin ose ushtrimin, në kushte të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut*”. Gjithashtu, neni 3 pika 6 e këtij ligji parashikon: *“Mohim i përshtatjes së arsyeshme’ është ajo formë diskriminimi që ndodh kur mohohet ose kundërshtohet kryerja e rregullimeve ose ndryshimeve të domosdoshme dhe të përshtatshme që janë të nevojshme në një rast të veçantë, pa vendosur një barrë të tepruar, me qëllim garantimin që personat me aftësi të kufizuara të mund të gëzojnë dhe të ushtrojnë, në kushte të barabarta me të tjerët, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut*”.

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*, i cili ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre, të barabartë në shoqëri.

Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

Jetesa e pavarur, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Ligji nr. 93/2014, përcakton se, një nga aspektet që siguron jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara është edhe aksesin në shërbime.¹³

Duke mbajtur parasysh detyrimin që Konventa e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*, ka vendosur për shtetet, jo vetëm për të miratuar të gjitha masat e duhura legjislative dhe administrative, si dhe masa të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura nga Konventë, por edhe për të marrë të gjitha masat e duhura, përfshirë legjislacionin, për të

¹³Neni 5, pika 1, e ligjit nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”* parashikon: *“Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.”*

modifikuar apo zhvlerësuar ligjet, rregulloret, zakonet dhe praktikat ekzistuese që përbëjnë diskriminim ndaj personave me aftësi të kufizuara, ligji “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë”, ka përcaktuar në nenin 20 se: *“Bazuar në këtë ligj, institucionet përgjegjëse ndërmarrin ndryshime graduale në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të përshtatur formulimin, termat, synimin dhe qëllimin me modelin dhe imazhin bashkëkohor të dëmtimit dhe aftësisë së kufizuara, veçanërisht me autonominë dhe të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për jetesë të pavarur dhe me përfshirjen e tyre në të gjitha sferat e jetës, në kushte të barabarta me të tjerët.”*

Gjithashtu neni 1¹⁴ Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) siguron mbrojtje kundër diskriminimit në gëzimin e të drejtave të përcaktuara me ligj, si dhe afirmon ndalimin e diskriminimit nga ana e autoriteteve publike. Në interpretim të nenit të kësaj konvente, një person është i diskriminuar, për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 14 të KEDNJ-së, nëse nga sjellja (veprimi ose mosveprimi) e autoriteteve shtetërore, i mohohet gëzimi i të drejtave, që legjislacioni kombëtar i njeh individëve në mënyrë specifike, të cilat rrjedhin nga një detyrim i qartë i një autoriteti publik sipas legjislacionit kombëtar, nga një autoritet publik në ushtrimin e pushtetit diskrecional, si dhe nga çdo veprim ose mosveprim tjetër i një autoriteti publik¹⁵.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Bazuar në nenin 3/9 të LMD të ndryshuar: *“Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme”* është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

Neni 20, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, siguron mbrojtje të individëve nga diskriminimi në fushën e të mirave e shërbimeve. Neni 20, parashikon shprehimisht:

¹⁴ Neni 1, Protokollin 12 i KEDNJ, parashikon shprehimisht: *“1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër. 2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”*

¹⁵ Shih Sejdic dhe Finci kundër Bosnjë-Hercegovinës (2009); Savez Crkava “Rijec Zivota” dhe të tjerët kundër Kroacisë nr. 7798/08, § 58, 9 dhjetor 2010);

“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

.....

b) mundësi për të marrë ose për të përfutur nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin;

c) kontributin dhe mundësinë për të përfutur të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;

.....

3. Ndalohet për një person fizik ose juridik, që ofron të mira dhe shërbime për publikun, të mos pranojë ose të kundërshtojë realizimin e ndryshimeve ose përshtatjeve të nevojshme dhe të duhura, të cilat synojnë të mundësojnë përfitimin e këtyre të mirave dhe shërbimeve nga një person me aftësi të kufizuara, për sa kohë që këto modifikime apo përshtatje nuk imponojnë një barrë të shpërpjesëtuar ose të paligjshme mbi personin që ofron të mirat dhe shërbimet.

4. Refuzimi, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin edhe situata kur refuzimi në fakt bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, por nga subjekti diskriminues deklarohen shkaqe të tjera, apo nuk deklarohet asnjë arsye si shkak i refuzimit.....”

Qeveria shqiptare me qëllimin që të nxisë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare, të parandalojë diskriminimin dhe të eliminojë pengesat për të pasur akses në shërbimet publike dhe realizimin e të drejtave të tyre, ka miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 483, datë 29.06.2016, “Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020”. Plani i Veprimit ka përcaktuar si qëllimi strategjik 1: “Të ofrohet akses i barabartë në shërbime dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara”.

Ligji Nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 8 parashikon se: “Përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar janë:

a) personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkakut dhe moshat;

b) personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe personat e paaftë për punë, sipas Komisionit

Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë;

c) personat me aftësi të kufizuar, të deklaruar të tillë me vendim të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar;

ç) personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, që përfitojnë pension invaliditeti dhe shtesë mujore mbi të, sipas Statusit të Invalidit të Punës”.

Neni 10, i ligjit të sipërcituar parashikon se: *“Përfitues të ndihmës personal: Personat përfitues, që përcaktohen në gerrat a, b, dhe c, të nenit 8, të këtij ligji, të cilët, me vendim të komisioneve të vlerësimit, të parashikuar nga ky ligj, përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë edhe një ndihmës personal me pagesë”.*

Në rastin konkret, edhe pse ankuesja ka bërë një kërkesë lidhur me ofrimin e shërbimit të pajisjes me kartë identiteti në banesë, për shkak të pamundësisë për të aplikuar pranë zyrave të Shoqërisë ALEAT sh.p.k dhe Ministrisë së Brendshme, nga ana e tyre nuk është marrë asnjë masë për t’i ofruar këtë shërbim. Ky shërbim i është ofruar ankueses me një kosto shumë herë më të lartë se kostoja e aplikimit për kartë identiteti, duke përfshirë aty edhe një shërbim që ankuesja nuk e ka kërkuar, siç është pajisja me pasaportë biometrike. Gjithashtu, aplikimi për pasaportë i është ofruar me një çmim që aplikohet në rastin e procedurave të përshpejtuara. Pra, mbi ankuesin rëndojnë dy kosto të panevojshme dhe të pa kërkuara, ai i pajisjes me pasaportë dhe çmimi i procedurës së përshpejtuar.

Gjithashtu, vihet se për këtë shërbim Shoqëria ALEAT sh.p.k., nuk ka përfshirë kosto të shërbimit jashtë zyrave të saj, si dhe nuk ka parashtruar pretendimin se ofrimi i këtij shërbimi në banesë përbën një barrë të tepruar për të. Në këtë kuptim, Komisioneri vlerëson se jemi në situatën e mohimit të përshtatjes së arsyeshme të parashikuar në nenin 3/9 të Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në bazë të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Referuar në nenin 6 të këtij ligji, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

Bazuar në nenin 33 pika 7/1 *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.*

Gjithashtu, referuar Komentit të Përgjithshëm Nr. 6(2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, në lidhje me përshtatjen e arsyeshme, ndër të tjera theksohet që personat me aftësi të kufizuara

nuk duhet të jenë ata që të mbajnë kostot dhe barra e provës për të treguar që barra është joproporcionale apo e padrejtë është e ofruesit të shërbimit.

Parimi i ndarjes së barrës së provës është ngulitur mirë tashmë në ligjin e BE dhe KEDNJ. KEDS¹⁶ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë një të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹⁷

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe provave të vëna në dispozicion nga ana e Shoqërisë ALEAT sh.p.k. dhe Ministrisë së Brendshme, rezultoi se pavarësisht komunikimeve ndërmjet njëri-tjetrit dhe evidentimit prej tyre të faktit që personat me aftësi të kufizuara apo për shkak të gjendjes shëndetësore, e kanë të pamundur të paraqiten fizikisht pranë Zyra të Aplikimit të ALEAT sh.p.k., asnjë prej këtyre dy subjekteve nuk vuri në dispozicion të Komisionerit fakte që provojnë se, për zgjidhjen e kësaj situatë janë ndërmarrë hapa për t'i garantuar akses të barabartë personave me aftësi të kufizuara në ofrimin e shërbimit për pajisjen e kartë identiteti apo pasaportë biometrike.

Rezulton që Ministria e Brendshme dhe Shoqëria ALEAT sh.p.k., kanë shprehur vullnetin e tyre duke ndryshuar dhe përmirësuar në disa raste Kontratën e Koncesionit "*Për prodhimin dhe shpërndarjen e letërnjoftimeve elektronike dhe pasaportave biometrike*"¹⁸. Pavarësisht këtyre ndryshimeve që i janë bërë Kontratës së Koncesionit, këto subjekte nuk kanë marrë asnjë masë për të siguruar ofrimin e shërbimit për personat me aftësi të kufizuara, për pajisjen me Dokumenta Biometrik të Identitetit, si në rastin e shtetases E.T.

Në analizë sa më sipër Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga Shoqëria ALEAT sh.p.k. dhe Ministrisë së Brendshme, kundrejt shtetases E.T dhe personave që ndodhen në të njëjtat kushte me të dhe si pasojë barra e provës bie tek këto subjekte.

¹⁶ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

¹⁷ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹⁸ http://www.atrako.gov.al/?page_id=659&contract=1165

Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, Shoqëria ALEAT shp.k. dhe Ministria e Brendshme duhet të përmbushnin dy kushtet e përmendura më sipër.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Shoqëria ALEAT shp.k. dhe Ministria e Brendshme, nuk vunë në dispozicion asnjë informacion lidhur me:

- Hapat e ndërmarrë apo procedurën e miratuar, për ofrimin e mundësisë së personave me aftësi të kufizuara apo të shtetasve të cilët ndodhen në kushtet e pamundësisë për t'u paraqitur fizikisht pranë Zyrave të Aplikimit për Dokumenta Biometrik të Identifikimit;
- Procedurën standarte për ofrimin e shërbimit në mënyrë të barabartë me shtetasit e tjerë, për personat me aftësi të kufizuara si në rastin e subjektit ankues;
- Tarifat standarte për ofrimin e shërbimit për pajisjen me Dokumenta Biometrik të Identitetit, për personat në nevojë që përfitojnë nga programet e ndihmës ekonomike apo që trajtohen me pagesë të aftësisë së kufizuar, të cilët nuk ndodhen në të njëjtat kushte me qytetarët e tjerë;
- Procedurën e miratuar, që personat në kushtet e ankueses, të mund të aplikojnë për Kartë Identiteti apo Pasaportë Biometrike, pa patur detyrimin që të paguajnë apo marrin shërbimin për të dy Dokumentat Biometrik të Identitetit njëkohësisht.

Përsa më sipër, nga informacioni i vënë në dispozicion nga Shoqëria ALEAT sh.p.k. dhe Ministria e Brendshme, vërehet se ka patur edhe raste të tjera në kushtet e shtetasës E.T, ku këto subjekte janë vënë në dijeni dhe nuk kanë ndërmarrë asnjë hap për të miratuar një procedurë standarte për lehtësimin e kostos apo të ofrimit të shërbimit për pajisjen me Dokumenta Biometrik të Identifikimit.

Gjatë procedurës të shqyrtimit të ankesës, nga ana e Shoqërisë ALEAT sh.p.k., nuk u parashtrua asnjë pretendim në lidhje me faktin, nëse ofrimi i përshtatjes së arsyeshme për rastin e shtetasës E.T përbënte një barrë disproporcionale dhe të padrejtë, pra një barrë të tepruar, edhe pse ligjërisht është detyrim i saj. Shoqëria ALEAT sh.p.k., pas kërkesës së ankueses nuk ka marrë masat e nevojshme për t'i ofruar një përshtatje të arsyeshme vajzës së saj, sipas parashikimeve të nenit 3/9 të Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar.

Komisioneri vlerëson se nga ana e Shoqërisë ALEAT shp.k. dhe Ministrisë së Brendshme nuk u arrit të provohej:

1. Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkaqeve të pretenduara nga ankuesja, që janë aftësia e kufizuar dhe gjendja shëndetësore dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë nga ana e Shoqërisë ALEAT shp.k. dhe Ministrisë së Brendshme, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
2. Që për veprimet dhe mosveprimet e këtyre subjekteve kundrejt ankueses dhe personave që ndodhen në kushte të njëjta me të, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që

këto veprimeve dhe mosveprimeve ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale.

Në analizë përse më lart, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë ka identifikuar përmes Vendimit Nr. 525, datë 08.08.2007 projektin për Koncesionin “*Mbi prodhimin dhe shpërndarjen e dokumentave të identitetit dhe pasaportave elektronike*”, dhe në pikën 2 të tij ka përcaktuar Ministrinë e Brendshme si autoriteti kontraktues për këtë projekt. Në këtë kuptim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vlerëson se Ministria e Brendshme, në cilësinë e autoritetit kontraktues, duhet të kishte marrë masat dhe të kishte parashikuar në kontratën koncesionare, procedura konkrete apo mundësi aksesit të nevojshëm që duhen përmbushur për personat me aftësi të kufizuara dhe personat të cilët për shkak të gjendjes shëndetësore e kanë të pamundur të paraqiten pranë zyrave të aplikimit për Dokumenta Biometrik të Identitetit. Në këtë mënyrë, Ministria e Brendshme do të kishte eliminuar barrierat me të cilat personat me aftësi të kufizuara në kushtet e E.T përballen aktualisht.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se Ministria e Brendshme, me anë të mosveprimeve të saj, ka vendosur përpara një situatë diskriminuese, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes shëndetësore, E.T dhe personat që ndodhen në të njëjtat kushte me të njëjta me të, sa i përket aksesueshmërisë.

Rezultoi se, shoqëria ALEAT sh.p.k., në cilësinë e koncesionarit, i cili ofron shërbimin e pajisjes me Dokumenta Biometrik të Identitetit, ka refuzuar që të kryejë ndryshimet/rregullimet e nevojshme për të ofruar shërbimin për t’u pajisur me kartë identiteti në ambientet ku qëndron shtetasja E.T. Ky ndryshim/rregullim i kërkuar në rastin e shtetases E.T, është e vetmja mënyrë që ajo të përfitojë shërbimin, kjo për shkak se kjo shtetase e ka të pamundur të lëvizë. Në këtë mënyrë, Komisioneri gjykon se kërkesa për të ofruar shërbimin për tu pajisur me kartë identiteti në banesë, është një ndryshim/rregullim i përshtatshëm dhe i domosdoshëm për rastin e shtetases E.T. Në kushtet kur rezultoi se ofrimi i këtij shërbimi në banesë nuk përbën një barrë të tepruar, për ofruesin e shërbimit, në rastin konkret për shoqërinë ALEAT sh.p.k, Komisioneri arrin në përfundimin se shoqëria ALEAT sh.p.k. e ka vendosur shtetasen E.T përballë një situatë diskriminuese, të konsumuar në formën e mohimit të përshtatjes së arsyeshme.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se shtetases E.T i është mohuar përshtatja e arsyeshme, nga ana e Shoqërisë ALEAT shp.k. dhe aksesueshmëria nga ana e Ministrisë së Brendshme, të cilat do të bënin të mundur që E.T të aplikonte për kartë identiteti.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre*”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, përcaktohet: “*Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës*”

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktime të diskriminimit. Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në Komentin e Përgjithshëm Nr.6 (2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, në pikën 12, të tij shprehet se: *“Barazia dhe mosdiskriminimi janë parime dhe të drejta. Konventa u referohet atyre në nenin 3 si parime dhe në nenin 5 si të drejta. Ato janë gjithashtu një mjet interpretues për të gjitha parimet dhe të drejtat e tjera të mishëruara në Konventë. Parimet/e drejta për barazi dhe mosdiskriminim janë gur themeli i mbrojtjes ndërkombëtare të garantuar nga Konventa. Promovimi i barazisë dhe **trajtimi i diskriminimit janë detyrime ndërsektoriale të realizimit të menjëhershëm. Ato nuk i nënshtrohen realizimit progresiv.**”*

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetases E.T në formën e mohimit pështatjes së arsyeshme, nga ana e Shoqërisë ALEAT sh.p.k, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes shëndetësore.
2. Konstatimin e diskriminimit të shtetases E.T dhe shtetasve të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të, për shkak të aftësisë së kufizuar nga Ministria e Brendshme.
3. Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Shoqërisë ALEAT sh.p.k., për të garantuar ofrimin e shërbimit për pajisjen me kartë identiteti të shtetases E.T, në ambjentet e banesës dhe me koston normale të saj.
4. Në referencë të pikës 2, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat nga ana Ministrisë së Brendshme, për të parashikuar në kontratën koncesionare, procedura konkrete apo mundësi

aksesi të nevojshëm që duhen përbushur, për personat me aftësi të kufizuara të cilët e kanë të pamundur të paraqiten pranë zyrave të aplikimit për Dokumenta Biometrik të Identitetit.

5. Komisioneri *rekomandon* që Shoqëria ALEAT sh.p.k. dhe Ministria e Brendshme, brenda 3 (tre) muajve, të hartojnë një skemë/program të mënyrave lehtësuese për përfitimin nga shërbimi për pajisjen me kartë identiteti apo pasaportë biometrike, për personat të cilët janë të pamundur për shkak të gjendjes shëndetësore apo aftësisë së kufizuar.
6. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminim*”, Shoqëria ALEAT sh.p.k. dhe Ministria e Brendshme, detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
7. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
8. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Aftësia e kufizuar/Gjendja shëndetësore
Fusha: Shërbime
Lloji i vendimit: Diskriminim
Forma: Mohim i përshtatjes së arsyeshme
Diskriminim për shkak të mungesës së standarteve të aksesueshmërisë